

Lejet e ndërtimit


Tremujori II, 2024

Tiranë, më 30 Gusht 2024: Në tremujorin e dytë 2024 janë miratuar gjithsej 354 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 509 leje të miratuara në tremujorin e dytë 2023, duke shënuar një ulje prej 30,5 % (tab.2).

Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja, në tremujorin e dytë 2024 është 844.137 m², nga 652.136 m² miratuar në tremujorin e dytë 2023, duke shënuar një rritje prej 29,4 % (tab.3).

Në tremujorin e dytë 2024, vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike është 33.7 miliardë lekë, nga 24.4 miliardë lekë miratuar në tremujorin e dytë 2023, duke shënuar një rritje prej 38,1 % (tab.4).

Fig. 1 Struktura e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit, T2 – 2024



Për publikim 30/08/2024

Vijon

Tab. 1 Lejet e ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike, T2 - 2024

Llojet e Ndërtimeve	Numër	Sipërfaqe m ²	Ndërtime të reja 000 / lekë	Rikonstruksione 000 / lekë
Gjithsej			29.865.895	3.838.757
I. Ndërtesa	354	844.137	28.452.890	1.417.385
1.Ndërtime për banim (rezidente)	254	691.218	23.627.444	189.831
a. Me një kat	100	14.588	502.766	79.370
b. Me dy kate	88	23.442	738.799	95.556
c. Me tre ose më shumë kate	50	296.349	10.067.458	14.905
d. Rezidenca për komunitetet	16	356.839	12.318.421	0
2.Ndërtesa të tjera (jo rezidente)	100	152.919	4.825.446	1.227.554
a. Hotele dhe të ngjashme	10	11.825	472.977	858.981
b. Ndërtesa për zyra	1	41	1.646	0
c. Ndërtesa tregtare	24	11.260	381.569	5.319
d. Ndërtesa industriale	41	96.899	2.394.369	15.743
e. Ndërtesa të tjera	24	32.894	1.574.885	347.511
II. Punime Inxhinierike			1.413.005	2.421.372
1. Infrastruktura e transportit; Rrugë e autostrada			109.034	838.276
2. Linjat e ujësjellësve,elektrike dhe telekomunikacionit			615.024	1.569.096
3. Ndërtime komplekse në kantieret industriale			0	0
4. Punime të tjera inxhinierike			688.947	14.000

Burimi: Bashkitë. Ilogaritjet INSTAT

* Të dhënat për numrin dhe sipërfaqjen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab. 2 Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	II - 23	III - 23	IV - 23	I - 24	II - 24
Shqipëria	509	361	303	311	354
Berat	5	14	13	2	12
Dibër	4	3	2	0	0
Durrës	156	125	92	88	86
Elbasan	31	18	33	40	28
Fier	22	14	11	8	15
Gjirokastër	6	3	6	5	7
Korçë	42	43	25	27	27
Kukës	3	4	1	1	1
Lezhë	30	16	9	8	12
Shkodër	17	9	8	6	9
Tiranë	138	100	94	109	137
Vlorë	55	12	9	17	20

Burimi: Bashkitë. Ilogaritjet INSTAT

* Të dhënat për numrin e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab. 3 Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	II - 23	III - 23	IV - 23	I - 24	II - 24
Shqipëria	652.136	455.181	592.660	357.585	844.137
Berat	1.077	3.798	2.565	388	9.502
Dibër	1.978	1.958	3.507	0	0
Durrës	74.973	67.719	93.447	76.599	66.059
Elbasan	16.150	6.426	6.426	9.927	33.697
Fier	8.222	6.574	6.671	4.284	9.074
Gjirokastër	990	394	2.750	1.590	1.656
Korçë	10.826	22.622	17.220	13.001	15.593
Kukës	1.402	767	172	172	250
Lezhë	6.494	3.355	3.817	1.939	1.636
Shkodër	8.792	2.385	4.793	393	3.702
Tiranë	460.872	327.930	430.169	231.968	666.672
Vlorë	60.360	11.253	21.123	17.324	36.296

Burimi: Bashkitë. Ilogaritjet INSTAT

* Të dhënat për sipërfaqen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab. 4 Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Qarqet	II - 23	III - 23	IV - 23	I - 24	II - 24
Shqipëria	24.407.672	18.930.632	25.316.111	13.634.737	33.704.652
Berat	108.760	377.074	147.523	22.110	320.522
Dibër	161.577	157.802	198.802	5.356	3.374
Durrës	1.974.254	3.252.489	4.472.832	2.691.183	2.063.423
Elbasan	883.773	268.445	438.726	405.132	3.535.932
Fier	826.504	461.810	1.478.155	189.011	1.531.338
Gjirokastër	255.450	74.786	458.208	58.061	1.076.399
Korçë	491.155	907.488	828.493	459.497	643.450
Kukës	259.170	47.493	15.659	5.659	9.235
Lezhë	233.245	132.372	108.950	80.800	193.362
Shkodër	77.750	225.448	199.480	15.199	154.900
Tiranë	16.072.582	12.189.452	16.118.918	9.108.409	22.889.934
Vlorë	3.063.452	835.973	850.365	594.320	1.282.783

Burimi: Bashkitë. Ilogaritjet INSTAT

* Vlera e përafërt përfshin vlerën e ndërtimeve të reja dhe rikonstruksioneve.

Metodologjia

“Lejet e ndërtimit” është një publikim me frekuencë tremujore i cili ka për qëllim të paraqesë informacion mbi lejet e ndërtimit të miratuara për ndërtesa dhe punimeve inxhinierike në nivel qarku dhe vendi.

Informacioni statistikor rreth lejeve të ndërtimit të miratuara është një tregues afatshkurtër i cili paraqet zhvillimin e sektorit të ndërtimit në periudhën pasardhëse.

Treguesit kryesorë të lejeve të ndërtimit të miratuara të cilat paraqiten në këtë publikim janë:

- Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja,
- Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja,
- Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike.

Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i lejeve të ndërtimit grumbullohet nga zyrat rajonale të INSTAT në bashkëpunim me zyrat urbanistike të bashkive përkatëse.

Përkufizime

Leja e ndërtimit është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës.

Ndërtesat janë strukturat të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara, të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve. Ndërtesat klasifikohen në dy lloje të ndryshme kategorish: 1) Ndërtesa për banim (rezidente); 2) Ndërtesa të tjera (jo rezidente), ku përfshihen ndërtesat për hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa industriale, ndërtesa tregtare, etj.

Sipërfaqja është hapësira e përdorshme e ndërtesave të reja rezidenciale dhe jo-rezidenciale në metra katrorë ku vihet në zbatim projekti i miratuar. Kjo sipërfaqe matet brenda mureve të jashtme të ndërtesës duke përfshijtur: 1) zonat e ndërtimit si pjesët mbështetëse, kolonat, shtyllat, oxhaqet; 2) zonat me instalime të sistemit të ngrohjes apo ajrit të kondicionuar, gjeneratorët e energjisë; 3) zonat e shkallëve, ashensorëve.

Punime Inxhinierike janë të gjitha ndërtimet të pa klasifikuara në ndërtesa: hekurudhat, rrugë, autostrada, ura, linja ujësjellësash, linja elektrike dhe telekomunikacioni, etj.

Klienti është personi ose organi i cili kryen ndërtimin.

Burimi i të dhënave

Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga zyrat statistikore rajonale pranë bashkive përkatëse.